

P.nr.755/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i Përgjithshëm-Penal, gjyqtari, Kujtim Krasniqi, në çështjen penale kundër të pandehurve E.G. dhe L.P. që të dy nga O., për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Vjedhja nga neni 325 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.6577/17 të datës 16.02.2018, jashtë seancës, me datë 26.04.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë- departamenti i Përgjithshëm **PP.II.nr.6577/17 të datës 16.02.2018**, për shqiptimine urdhrin ndëshkimor,

Andaj gjykata konformë nenit 495 të KPPK-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

Të akuzuarve;

1.E.G., i ati R., i lindur mëdt:..., me vendbanim në rr. "W.", O., me nr. personal ..., shqiptar, – shtetas i Republikës së Kosovës.

2.L.,P., i ati N., i lindur më dt: ..., me vendbanim në rr. "W", O., me nr. personal ..., shqiptar, – shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

Sepse,

Të pandehurit E.G. dhe L.P., pas marrëveshjes paraprake, me datën 17.09.2017 rreth orës 22:00, me qëllim të përvetësimit të pasurisë së huaj të luajtshme, e vetit t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshme, kanë vjedhur thëngjill në M.S. në M., ashtu që nga shiritat transportues e kishin ngarkuar kamioneten me targa ..., pronë e të pandehurit E.G. me ç'rast ishin zënë në flagrancë nga policia, me ç'rast të dëmtuarës M.S. në M. i kanë shkaktuar dëm në lartësi prej mbi 900 (nëntëqind) €.

-me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Vjedhja nga neni 325 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform neneve 4, 41, 43, 46, 73 të KPK, si dhe neneve 365 e 495, të KPPK-së i shqipton

DËNIMIN ME GJOBË

Të pandehurve:

Secilit veç e veç në shumë prej **500(pesëqind) Euro**, të cilin dënim janë i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prere të këtij aktgjykimi, dhe

Dënimin e shqiptuar të pandehurit mundë ta paguajnë deri në 2 (dy) këste mujore në afat kohor prej 2 (dy) muaj, deri në datën 5 të muajit vijues nga dita e marrjes së formës së prerë e këtij aktgjykimi.

Në rast se të pandehurit nuk e paguajnë dënimin e shqiptuar, gjykata mundësinë e pagesës me këste do ta revokoj dhe konform nenit 46 të KPK-së i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi **duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burg.**

Obligohen:të akuzuarit që në mënyrë solidare në emër të shpenzimeve të procedurës penale gjykatës t'ia kompensojnë shumën prej **30** euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me detyrim.

Edëmtuara – M.S.M. KEK, lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë- Departamenti i përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.6577/17 të datës 16.02.2018, kundër E.G. dhe L.P. që të dy nga O., për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Vjedhja nga neni 325 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuarit sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor.

Prokurori i çështjes, Gjykatës i ka propozuar që kundër të akuzuarve të lëshoj Urdhrit Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërin e aktakuzës së prokurorisë në drejtim të vërtetimit të fakteve të cilat vërtetojnë faktin se të akuzuarit e kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 të KPPK-së Gjyqtari i vetëm gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK-së dhe vendosi që ta pranojë kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: Raporti nga komisioni i KEK-ut mbi dëmin e shkaktuar, Foto e kamionetës dhe thëngjillit, vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve dhe kthimin e sendeve, Raporti policor dhe Deklarata e të dyshuarve, janë prova të mjaftueshme me të cilat vërtetohet se të akuzuarit kanë kryer veprën penale e cila u vihet në barrë.

Andaj Gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale Vjedhja nga neni 325 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësorë, u mor konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i përgjithshëm-Penal

P.nr.755/18 dt. 26.04.2018

Zyrtare Ligjore
Dafian Ymeri

Gjyqtari,
Kujtim Krasniqi

KËSHILLA JURIDIKE;

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga marrja e të njëjtit, kësaj Gjykate, pas kalimit të afatit për kundërshtim urdhri ndëshkimor, merr formën e prerë.